

VENDIM
Nr. 350, datë 13.4.2023

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË,
KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË KOALICIONIT “PARTIA
DEMOKRATIKE - ALEANCA PËR NDRYSHIM”, PARTIA REPUBLIKANE SHQIPTARE
(PR) (QARKU ELBASAN, Z. QANI REXHEP XHAFA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n”, e 2, 163, pika 7, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; dhe të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 1052/2 prot., datë 27.3.2023, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e dorëheqjes nga mandati i deputetit, të z. Luçiano Dhimitër Boçi, i zgjedhur në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, propozuar nga koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”.

Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 107, datë 2.3.2021

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të zhvilluara në datë 25.4.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit nr. 416, datë 23.6.2021, miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues, si dhe rirenditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.4.2021.

Sipas këtij vendimi, koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim” për zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, ka fituar 6 (gjashtë) mandate.

Rezulton se lista shumemërore e koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164 pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 416, datë 23.6.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në të cilin është miratuar rirenditja e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi, rezulton se kandidatit të cilit i kalon mandati i deputetit është kandidati me numër rendor 07 (shtatë), z. Qani Rexhep Xhafa.

Me shkresën nr. 2226 prot., datë 29.3.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për deputet, të listës shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, z. Qani Rexhep Xhafa, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Kandidati për deputet, z. Qani Rexhep Xhafa ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 15 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Qani Rexhep Xhafa, rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën III “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”

Pyetjes 4, “A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues i është përgjigjur “Po”, duke deklaruar, se: “Është ndaluar nga autoritetet për drejtim automjeti në mënyrë të parregullt”, më datë 11.3.2023, çështje për të cilën është nën hetim.

Pyetjes 5, “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo?”, subjekti vetëdeklarues i është përgjigjur “Po”, duke deklaruar, se: “Është caktuar masa e detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Për drejtim automjeti në mënyrë të parregullt, më datë 11.3.2023, çështje për të cilën është nën hetim në vazhdim.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatoj, se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Qani Rexhep Xhafa, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Shqipërisë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe kreut V, pika 2, shkronja “b”, dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, nëpërmjet komunikimit elektronik ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, si dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Qani Rexhep Xhafa, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Qani Rexhep Xhafa.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Qani Rexhep Xhafa, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstatoj se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Qani Rexhep Xhafa, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Luçiano Dhimitër Boçi, i përket kandidatit vijues në listën shumëmemërore të koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”, Partia Republikane Shqiptare (PR) në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, i renditur me numër rendor 07 (shtatë), z. Qani Rexhep Xhafa.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n”, e 2, 163, pika 7, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015,

“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; dhe në kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”, Partia Republikane Shqiptare (PR) në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, z. Qani Rexhep Xhafa.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONER SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Ilirjan Celibashi